



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr.28/2023

Nr. Protokolli: 40/2023

Për:	Limit L & B SH.P.K. Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Fatos Kuqi Shef i zyres se Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	05.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, **Kerkeses për Rishqyrtim** të derguar në Platforme Elektronike të datës: **02.05.2023** të parashtruar nga "**Limit L & B SH.P.K. Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave** me Nr. të Prokurimit: **624-22-12145-2-2-1 & 624-22-118-221** nxjerr këtë

V E N D I M

I. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **02.05.2023** të parashtruar nga operatori ekonomik: **Limit L & B SH.P.K. Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave** me Nr. të Prokurimit: **624-22-12145-2-2-1 & 624-22-118-221** nxjerr këtë

I.Vërtetohet **NJOFTIMI PER DHENJE TE KONTRATES** të publikuar me datë: **25.04.2023**

II.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me dhënie të Kontratës për këtë aktivitet të prokurimit.

III.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 02.05.2023 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik " **Limit L & B SH.P.K., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave** me Nr. të Prokurimi: **624-22-12145-2-2-1 & 624-22-118-221** nxjerr këtë

***Pretendimi nr.1** - Te kërkesa 2 ku eshte kërkuar qw OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, min. (5) pese punëtorë të mjaftueshëm përkryerjen e projektit, ndersa si dëshmi dokumentare te ofrohet: Dëshmia 2 - Lista e punetoreve duhet te përmbaj këto te dhëna Emri, mbiemrin, moshja e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Listes ti bashkangjiten këto dëshmi Kontrata e punës apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe e vulosur nga Punëdhënsi, të dorëzohet në kopje.*

Grupi i OE te rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për arsye se nuk ka dëshmi se 5 punëtorët janë te lajmëruare ne ATK gjë qe dëshmonte qe këta punëtor janë aktiv ne ketë projekt dhe projekte tjera, gjithashtu kontrata e paraqitura nga grupi i OE te rekomanduar për kontrate janë te dyshimta. pra janë ofrua kontrata por nuk ceket askund qe këto kontrata kanë te bëjnë me ketë aktivitetin e prokurimit, ashtu si qeshte cekuar te kërkesa.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 1. – sa i perket ketij pretendimi ankimor nuk qendron pasi qe OE ne ofereten e tij ka dorezuar listen e stafit te kompanis e cila eshte e nenshkuar dhe vulosur, poashtu ka bashkangjitur kontratat e punës per te gjithë te punesuarit ne kompani.

***Pretendimi nr.2** - Te Kërkesa 3 - Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme dhe atë b) Udhëheqës i punishtes bachelor I Komunikacionit me se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Duhet te ketë udhëhequr se paku nje (1) kontrata te natyrës se ngjashme, ndersa deshmi dokumentar te ofrohet Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur. Listes duhe ti bashkangjiten këto dëshmi - Diploma kopje; CV-ja kopje e nënshkruar; Referencat ; - Kontrata e punës apo Parakontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi, dhe -Vendimi I nenshkuar dhe I vulosur nga perfaqsesi I OE per emrimin e menagjerit dhe udhëheqësit të punishtës te kontrates sipas kërkesave ne pikat a) dhe b).*

I rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e lartcekur sepse udhëheqësi i punishtes nuk ka ofruar dëshmi se ka udhëhequr se paku një projekt te sinjalizimit vertikal dhe horizontal, pra nuk dëshmohet ashtu si qeshte kërkuar nga vet AK-ja. Po ashtu nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete se ky udhëheqës i punishtes qe ka 2 vite përvojë te punës profesionale. Pra edhe ne këtë pik i rekomanduari për kontratë është i papërgjegjshëm.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 2 - sa i perket ketij pretendimi ankimor nuk qendron pasi qe OE per projektin ne fjale ka lidhur Parakontratë pune me ing. Perkates ne te cilen theksohet qartazi se ing. do te kryejne pune te percaktuar me kete kontrate e cila i parasheh rregullat se qfare pune do te kryejne keta dy ing.

Ne parakontrata e punes ne fjale theksohet se: i punesuari do ti kryej punet e percaktuara nga menaxheri i kompanisë ne baze te projektit ne fjale: **“Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave”** dhe kjo e konfirmon zyrtarizimin e kesaj parakontrate sepse eshte e nenshkuar nga te dyja palet.

Pretendimi nr.3 - kërkesa 4, e ku është kërkuar: *Marrveshje me prodhuesin e rampave, apo distributorin e autorizuar te prodhuesit, ndersa deshmi dokumentare te ofrohet Marrveshja me prodhuesin rampave, apo distributorin e autorizuar te prodhuesit te bollardsave-pistonave hidraulik.*

Ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një marrëveshje me kompaninë “Globbus Group” e cila nuk është prodhuese e rampave te kërkuara pra te bollardsave-pistonave hidraulik, mirëpo vetëm është distributore e rampave por per te cilën mungon kontratë me prodhuesin direkt me kompaninë “NICE”. Po ashtu edhe kompania “NICE” eshte prodhuese e rampave normale por nuk është prodhuese e **bollardsave-pistonave hidraulik-shtylla zhytëse.**

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 3 - sa i perket ketij pretendimi ankimor nuk qendron sepse OE posedon marrveshje bashkpunimi me kompanin **“Globbus Group”** e cila eshte distributore e kompanis “NICE”

Pretendimi nr.4 - Grupi i OE te rekomanduarve per kontratë ju mungon marrëveshja me prodhuesin apo distributorin e gypave-shtyllave te zingtuara, e cila nuk e plotëson kerkesen e 6 ku eshte kërkuar *“Marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të prodhuesit te shtyllave metalike te zinguara (per shtyllat e shenjave të komunikacionit)”*.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 4 - sa i perket ketij pretendimi ankimor nuk qendron sepse OE na ka ofruar nje marrveshje-kontratë e cila eshte e nenshkuar dhe e vulosur e cila garanton OE qe kompania ne fjale merret me prodhimin e shtyllave.

Pretendimi nr.5 - Po ashtu grupi i OE te rekomanduar per kontratë ne prezantimin e *“planin e menaxhimit te trafikut”* nuk ka te dhënat informative se ky plan i dedikohet këtij aktiviteti te prokurimit , mirëpo len te dyshohet se ky plan menaxhimi është krejtësisht për tjetër aktivitet te prokurimit. Pra me kete dëshmohet se nuk eshte plotësuar as kërkesa numër 8 *“Plani i menagjimit të trafikut me rast specifik qytetin e Suharekës e nenshkuar nga inxhinieri apo bachelori i Komunikacionit”*.

Përgjigjësja e AK-ës ndaj pretendimit nr 5 - sa i perket ketij pretendimi ankimor nuk qendron sepse OE ka ofruar Planin e menaxhimit te trafikut i cili eshte i nenshkuar dhe i vulosur nga ing. i komunikacionit I cili plan permban te gjitha specifikat e duhura per realizimin e projektit ne fjalë.

Komisioni gjate vlersimit te ofertave ka respektuar nenin 59 te LPP-se si dhe nenin 7 te LPP-se. si dhe ne pretendimin tuaj qe nuk kemi respektuar kriterin kryesore (çmimi me i ulet) nuk qendron per arsye se oferta e juaj eshte me e larte se oferta e OE fitues.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shef i zyrës së Prokurimit
Fatos Kuqi

